



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmenjao/Prilato Received/Delivery	22.07.2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlopje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
4268/2022			1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.515/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.515/2022 të datës 08.06.2022, e parashtruar nga ankuesja me adresë: kundër organit të punësimit Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër Anr.515/2022 e datës 08.06.2022, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Komuna e Obiliqit, sipas njoftimit të datës 09.12.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për grupin „Specialist të Arkivi-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar për Arkiv 3”, me numër reference RN00007958 për afatin për aplikim nga data 31.12.2021 deri me datë 11.01.2022, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Komuna e Obiliqit, i publikuar sipas njoftimit të datës 09.12.2021, për grupin „Specialist të Arkivi-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar për Arkiv 3”, në Drejtorin e Administratës së Përgjithshme me numër referencës RN00007958, me datë 31.12.2021, në të cilën procedurë ankuesja ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, ankuesja është njoftuar me datë 29.04.2022 lidhur me pikët e arritur, gjithsejtë 73.4 pikë, duke u renditur e dyta në listën përfundimtare.

E pa kënaqur me rezultatin e datës 29.04.2022, ankuesja ka parashtruar ankesë tek Komisioni për praninë, me pretendime ankimore se testi me shkrim nuk ka qenë profesional, gjegjesisht testi me shkrim ka qenë i njejtë me pozitën e tjera që kanë qenë të shpallura tri javë më heret nga Komuna e Obiliqit, si dhe komisioni i pranimit nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejtë lidhur me kualifikimin respektivisht arsimimin.

Me datë 11.05.2022 Komisioni për vlerësim ka nxjerrë përgjigje në ankesë me numër XII/161, duke arsyetuar se testi me shkrim ka qenë në harmoni me Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Praninë dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe mund ta kërkonte tek Ministria e Administratës Publike sepse Ministria nuk na ofron kopjen e testit të asnjë kandidati, kurse pretendimet e tjera për vlerësimin e biografisë, vlerësimin me shkrim si dhe vlerësimet e tjera janë në kompetencë të komisionit i cili është i pavarur dhe vlerësimi bëhet në mënyrë individuale, duke u udhëzuar për të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit ligjor.

Ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e datës 11.05.2022 ka parashtruar ankesë me datë 08.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit të ankesës me të njëjtat pretendime lidhur me testi me shkrim që nuk ka qenë profesional, dhe përmbajtja e testi nuk është përpiluar siç është bërë për pozitën e tjera që kanë qenë në Komunë të Obiliqit, dhe nuk e ka përmbajtjen e pyetjeve profesionale, duke pretenduar se komisioni nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë nga rezultati i verifikimit paraprak deri tek rezultati përfundimtar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.06.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Komuna e Obiliqit. Ndërsa Këshilli me datë 27.06.2022 ka pranuar nga Komuna e Obiliqit përgjigjen e protokolluar me numër: 3715/2022 përmes formës elektronike, dhe me datë 14.07.2022 Këshilli përmes zyrtarit të lartë për bashkëpunim profesional ka parashtruar kërkesë tek NBNJ-të të Komunës së Obiliqit, në mungesë të provave për procedurën e rekrutimit, i cila me datë 18.07.2022 ka bashkangjitur me shkresat e përgjithshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3331/2022 të datës 08.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 21.01.2022; Përgjigjen/vendimin me numër XII/161 e datës 11.05.2022; Konkurs i shpallur me datës 09.12.2022; Vërtetim i datës 13.04.2016; Letër rekomandim e datës 13.04.2016; Certifikatë e datës 1.03.2017 deri me datës 01.12.2017; Certifikatë e datës 29.07.2016; Referencë e datës 15.06.2016; Diplomë e datës 03.11.2016 nr.4292; Diplomë e shkollës së mesme e datës 05.07.2012; Certifikatë e datës 01.06.2012 nga MASHT; Certifikatë e datës 27.06.2012 nga MASHT; Certifikatë e datës 23.02.2010 nga MASHT; Kontratë e punës e datës 01.09.2018; Certifikatë e datës 15.07.2021 nga Gjykata Themelore Prishtinë; Rezultati përfundimtar me numër protokoll XII/156 i datës 29.04.2022; Ankesa tek Komisioni për praninë; Përgjigje në ankesë përmes e-mailit zyrtar i datës 27.06.2022 me numër protokoll 3715/2022, me E-mail i datës 24.06.2022; Përgjigje në ankesë për KPMSHCK-së me numër XII/189 e datës 24.06.2022; Email i datës 27.06.2022; Vendimi i datës 14.03.2022 me numër protokoll II-235; E-mail i datës 17.03.2022; lista e aplikuarve, SIMBNJ të aplikacioneve aprovues dhe refuzues; E-mail i datës 13.04.2022; E-mail i datës 29.03.2022 Njoftim; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 29.04.2022 e nxjerrë nga SIMBNJ-së; Rezultati përfundimtar me numër protokoll XII/156 i datës 29.04.2022;

Aplikacioni i ankueses i datës 31.12.2022; Diploma Nr.633 i datës 05.07.2012 i lëshuar nga Shkolla e Mesme "Hasan Prishtina" në Mitrovicë në drejtimin- Administratë Asistent juridik; Diplomë nr.4292 e Fakultetit Juridik Universiteti "Hasan Prishtina; Vendim i datës 27.02.2019; Aplikacioni i datës 05.01.2022 Diploma Nr.631 i datës 01.07.2015 i lëshuar nga Shkolla e Mesme Gjinnazi "17 shkurti", në Komunë të Obiliqit në drejtimin- Shkenca shoqërore; Diplomë nr.9365 i datës 19.09.2018 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina-fakulteti Ekonomik; Vërtetim i datës 04.08.2021; Vërtetim i vitit 2021 lëshuar nga KQZ; Referencë e datës 03.08.2021; Kërkesë për prova shtesë nga KPMSHCK-së me datës 14.07.2022; **Përgjigje e datës 18.07.2022 sipas kërkesës së KPMSHCK-së për prova shtesë; Aplikacioni i datës 08.01.2022 Diploma Nr.5019** Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina ; Diplomë e shkollës së mesme e datës 05.06.2018; Certifikatë e datës 04.04.2016; Pasqyre e notave lëshuar nga Kolegji AAB e datës 15.01.2021 me CV; Kontrate e punës e datës 03.06.2009; Aplikacioni i datës 10.01.2022 Diplomë e shkollës së mesme e datës 16.05.2016; Diploma Nr.2424/19 Kolegji ABB, Referencë e datës 01.05.2017; Vërtetim e datës 14.05.2019; Aplikacioni i datës 10.01.2022 Diplomë e shkollës së mesme "17 shkurti", në Obiliq e datës 06.06.2017; Diploma Nr.11210 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina-fakulteti Menaxhimin dhe Informatikë me datë 21.09.2020; Vërtetim e datës 16.10.2021; Certifikatë e datës 19.06.2015 mbi praktikën; letër reference të datës 26.10.2021; Certifikatë e notave e datës 26.10.2021; Aplikacioni i datës 11.01.2022 Diploma Nr.307 i datës 06.07.2012 i lëshuar nga Shkolla e Mesme Gjinnazi "17 shkurti", në Komunë të Obiliqit në drejtimin- Shkenca shoqërore; Aplikacioni i datës 01.01.2022 Diploma Nr.258 i lëshuar nga Shkolla e Mesme "Sami Frasheri", në Komunë të Prishtinës në drejtimin- Shkenca shoqërore; Diploma Nr.2928 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me datës 15.11.2013; Diplomë e datës 09.07.2020; Certifikat e datës 14.04.2013; Aplikacioni i datës 11.01.2022 Diploma Nr.180 e datës 21.06.2010 e lëshuar nga Shkolla e Mesme "17 shkurti", në Komunë të Obiliqit-drejtimi shkenca shoqërore; Diplomë nr.5223 e datës 02.06.2015, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Rezultatet e vlerësimeve të nxjerra nga sistemi SIMBNJ-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankueses *është e pa bazuara, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka kontaktuar se Komuna e Obiliqit, sipas njoftimit të datës 09.12.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për grupin „Specialist të Arkivit-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar për Arkiv 3”, me numër reference RN00007958 për afatin për aplikim nga data 31.12.2021 deri me datë 11.01.2022, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesja ka aplikuar në konkursin me numër referencë RN00007958, me emrin e grupit „Specialist të Arkivit-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar për Arkiv 3”, e shpallur nga Komuna e Obiliqit sipas njoftimit datës 09.12.2021 për aplikim nga data 31.12.2021 deri me datë 11.01.2022, në të cilën procedurë ankuesja ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale dhe ligjore, respektivisht testi me shkrim nuk ka qenë profesional, konkretisht ankuesja pretendon se testi me shkrim ka qenë i njejtë me pozitën e tjera që kanë qenë të shpallura tri jave me heret nga Komuna e Obiliqit, si dhe

komisioni i pranimit nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejtë lidhur me kualifikimin respektivisht arsimimin, po ashtu ankuesja më tej pretendon se CV e saj është më e mirë se e kandidatëve tjerë po ashtu ankuesi pretendon se CV e tij është vlerësuar me 12.8 pikë ndërsa është dashtë të vlerësohet me 20 pikë.

Sipas konkursit me numër reference RN00007958, sipas njoftimit të datës 09.12.2021 i shpallur për aplikim nga data 31.12.2021, për grupin „Specialist të Arkivit-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar për Arkiv 3”, në Komunën e Obiliqit, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e shkollës së mesme apo ekuivalente me to, fusha e kërkuar e arsimit: Drejtësi /Histori/ letërsi arkivistik,*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar tridhjetë e katër(34) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përzgjedhur tetë (8) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit dhe ka marrë pjesë në testin me shkrim, pasi që me datë 13.04.2022 është njoftuar se ka arritur gjithsejtë 53 pikë nga testi me shkrim dhe është ftuar për intervistë me gojë, pas mbajtjes së intervistës me gojë të datës 19.04.2022 ankuesja është vlerësuar nga Komisioni i pranimit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: “1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit. i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht neni 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë”, dhe pretendimet e ankueses janë të pa bazuara pasi që në rastin konkret ankuesja me datë 29.04.2022 është njoftuar lidhur me pikët e përgjithshme të arritur me gjithsejtë 73.04 pikë, duke u renditur e dyta në listën përfundimtare.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale tek përpilimi i testit me shkrim dhe tek jetëshkrimi sepse tek jetëshkrimi është vlerësuar me 12.8 pikë ndërsa është dashur të vlerësohet me 20 pikë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të nenit 22 paragrafit 1, 2 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, që ka përcaktuar se: “1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet”, ndërsa Komisioni i Vlerësimit në bazë të dokumentacioneve ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për kandidatët ku ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 12.8 pikë, konkretisht tek pjesa *për cilësinë dhe nivelin e arsimimit ankuesja është vlerësuar me piket maksimale*, andaj në këtë rast pretendimi i ankuesit është i pabazuar sepse vlerësimi për këtë pjesë është bërë në mënyrë të drejtë ndërsa sa i përket përpilimit të testit me shkrim Kolegji konstaton se testi është përpiluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji, po ashtu ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit me datë 29.04.2022 ka publikuar Renditjen përfundimtare me numër protokoll XII/156 lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit për grupin *Specialist të Arkivit-Dokumentacionit* për pozitën „Zyrtar për Arkiv 3“, duke bërë renditjen përfundimtare sipas listës së rezultateve përfundimtare të tre kandidatëve me mbi 70 pikët e arritura, ndërsa si kandidat i suksesshëm është përzgjedhur

që ka arritur gjithsejtë 76.8 pikët e përgjithshme, andaj Kolegji konstaton se publikimi është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është theksuar se: **“2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues”**, dhe ankuesja është renditur e dyta me gjithsejtë 73.4 pikët e përgjithshme, që në rastin konkret ankuesja në bazë të kësaj dispozite ka arritur mbi 70 pikët, por në raport me kandidatin e suksesshëm nuk ka arritur më shumë që të jetë e përzgjedhur si candidate e parë, se kandidati i përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara dhe ka konstatuar se Komisioni i Pranimin me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për grupin *Specialist të Arkivit-Dokumentacionit* për pozitën „Zyrtar për Arkiv 3“, në Komunën e Obiliqit si kandidat i cili ka grumbulluar me së shumti pikë të përgjithshme me gjithsejtë 76.8 pikët, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se:“ nenin 24. **Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit**”, duke përzgjedhur kandidatin e suksesshëm nga kjo procedurë e rekrutimit, i cili posedon posedon Diplomë me numër me numër 9365 të datë 19.09.2018, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me të cilin dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Ekonomik ,Departamenti Ekonomik me date 17.09.2018 dhe ka marr titullin Bachelor në Ekonomik si dhe Diplomë me numër 631 të datës 01.07.2015, lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë -Gjimnazi “17 Shkurti”, në Obiliq, me të cilin dëshmohet se ka përfunduar Shkollën e Mesme të Lartë në profilin „Shkenca Shoqërore“.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Zyra e Personelit në Komunë të Obiliqit, me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare sipas formularit të nxjerrë nga Komisioni për pranim lidhur me rezultatin përfundimtar me numër protokoll XII/156 të datës 29.04.2022 dhe Raportit të sistemit SIMBNJ-së të datës 29.04.2022 rezultateve finale për pozitën: **“Zyrtar për arkivë 3 ”**, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për pranim në Komunë të Obiliqit, me rastin e nxjerrjes së përgjigjes/vendimit me numër protokoll XII/161 të datës 11.05.2022 për ankesën e ankueses të datës 29.04.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse është vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses duke konstatuar se perpilimi i testit me shkrim, vlerësimi i biografisë, respektivisht jetëshkrimi është bërë konform ligjit dhe akteve nënligjore.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e konkursit sipas njoftimit të datës 09.12.2021 e shpallur për aplikim nga datë 31.12.2021, për grupin „*Specialist të Arkivit-Dokumentacionit*“ për pozitën „Zyrtar për Arkiv 3“, në Komunën e Obiliq, me numër reference RN00007958 është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit

Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.515/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;